



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 718, datë 06.12.2023**

**PËR**

**SHPALLJEN E VENDEVE VAKANTE NË POZICIONIN E NDIHMËSIT LIGJOR,  
NË NJËSINË E SHËRBIMIT LIGJOR NË GJYKATAT E APELIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenin 90, pika 1/b, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 55, 56, 57, 58 dhe 59, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe nr. 424, datë 12.10.2020 “ Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

**VENDOSI:**

1. Shpalljen e 2 (dy) vende vakante, në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit si më poshtë:
  - Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm - 1 (një) pozicion ndihmës ligjor;
  - Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit -1 (një) pozicion ndihmës ligjor;
2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për vijimin e procedurave të pranimit në shërbimin civil gjyqësor sipas dispozitave të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**